

VENDIM
Nr. 863, datë 10.12.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 173, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2014”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 3 e 7, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të vendimit nr. 173, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, vlera prej “154 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë) lekë” ndryshohet dhe bëhet “49 100 000 (dyzet e nëntë milionë e njëqind mijë) lekë”.

2. Vlera prej 104 900 000 (njëqind e katër milionë e nëntëqind mijë) lekësh, e papërdorur si bashkëfinancim për projektin IPA 2011, të përdoret për mbështetjen e prodhimit bujqësor blektoral dhe agropërpunimit, në përputhje me vendimin nr. 173, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama